REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr 1899 Prot Maliq, më 30.03.2026

VENDIM

Nr 49, datë 27.03.2026

"PËR IDENTIFIKIMIN E PASURISË NË FSHATIN LEMINOT, NJËSIA ADMINISTARTIVE PIRG"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" , i ndryshuar, neni 8, neni 9,pika 1, nënpika 1.1 , gërma "b"neni 64, "*Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë", gërma c*, neni 54 "*Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak"* pika LL, ligjit nr. 107/2014 për "*planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", neni 12, "*Përgjegjësitë e këshillit bashkiak",* Kërkesës të disa fermerëve të fshatit Leminot, Njësia Administartive Pirg, datë 17.02.2026, protokolluar pranë Bashkisë me nr. 1729 prot, datë 23.02.0206, Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 130 datë 12.03.2026, si dhe relacionit të bërë nga grupi i punës, Këshilli i bashkisë Maliq,

VENDOSI:

1. Të miratohet nga Këshilli Bashkiak kërkesa e bërë nga disa fermerë të fshatit Leminot, Njësia Administrative Pirg, numri i pasurisë dhe llojin e pasurisë, e cila është e pa identifikuar me numër pasurie dhe për rrjedhojë nuk është pasqyruar në Rregjistrimin Fillestar me kartele pasurie të veçantë të llojit rrugë për të bërë rregjistrimin e saj pranë ASHK Korçë për tu pajisur me numër pasurie pasi në ASHK figuron me numër X.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve në Bashki.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar.

Miratuar me 17 vota
Vota Pro 17
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 30.03.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

BASHKIA MA Q
Zyra e Protokollit
Nr. 1899/1 Prot.
Date 10.4.26

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
PREFEKTI I QARKUT KORÇË

Nr. 413/1 Prot.

Korçë, më 08.04.2026

Lënda: Mbi shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve të Këshillit

KËSHILLIT TË BASHKISË MALIQ

KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Mbështetur në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, pas verifikimit të vendimeve nr. 45, nr. 46, nr. 47, nr. 48, datë 27.03.2026 të Këshillit të Bashkisë Maliq, ***konfirmohet bazueshmëria ligjore e tyre,*** bazuar në nenin 3, 8, 9, 27, 29, 41, 54, 55, 64 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, në ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në ligjin nr. 35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", i ndryshuar, në vendimin nr. 328, datë 31.5.2023 të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 26.06.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar", i ndryshuar me vendim nr. 127, datë 27.02.2026, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjëve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", i ndryshuar së fundmi me vendim nr. 87, datë 6.2.2026, në vendimin e Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 2, datë 08.01.2026 "Rishqyrtim i vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 147, datë 24.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës të Bashkisë dhe strukturave të tjera të varësisë", i ndryshuar, në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", në ligjin nr. 57/2020 "Për pyjet", në ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", i ndryshuar, në ligjin nr. 10 431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, në ligjin nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", në ligjin nr. 152, datë 21.12.2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", i ndryshuar, në ligjin nr. 94/2025 "Për vullnetarizimin", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive", i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 467, datë 31.07.2025 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1156, datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhen në zonat e mbrojtura, të masës dhe kritereve të përdorimit të tyre", i ndryshuar, në udhëzimin nr. 1, datë 10.05.2024 "Për procedurat e dhënies në përdorim të përkohshëm të territoreve kullota, pjesë e zonave të mbrojtura", udhëzim i Ministrisë së Mjedisit nr. 2, datë 20.07.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari".

Shënim : Referuar nenit 34, pika 6 e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe referuar udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", faza e parë e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, pika 63, afati kohor i miratimit të tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm nga Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore është jo më vonë së data 15 mars. Lutemi në vazhdimësi të respektohen afatet kohore sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore.

Lidhur me vendimin nr. 49, datë 27.03.2026 të Këshillit të Bashkisë Maliq, institucioni i Prefektit të Qarkut konsideron që akti nuk plotëson kriteret e aktit administrativ normativ, pasi nuk krijon norma të përgjithshme, por zgjidh një situatë konkrete administrative. Si rezultat, shqyrtimi i ligjshmërisë së këtij vendimi nga institucioni i Prefektit të Qarkut tejkalon kompetencat e dhëna me ligj.

PREFEKTE

FLORINDA ZEGULLA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË-KORÇË
PREFEKTI I QARKUT